



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.45/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Luri” shpk, me seli në Han i Elezit, me nr. unik identifi. 810300989, kundër debitorit “Construct” shpk, me seli në Lebane, komuna e Prishtinës, me bazë juridike përmbarimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.102/2023 të datës 30.10.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Gjakovës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.102/2023 i datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.102/2023 të datës 30.10.2023, ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit kundër debitorit “Construct” shpk, me seli në Lebane, komuna e Prishtinës të paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.402/22 të datës 15.11.2022, të lejuar nga përmbaruesi privat Sheremet Livoreka, si të pas afatshëm.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e themeltë ankesa, ashtu që aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Luri” shpk, me seli në Han i Elezit, me nr. unik identi. 810300989, me datë 15.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit “Construct” shpk, me seli ne Lebane, komuna e Prishtinës, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 223,709.42 Euro.

Përmbaruesi privat Sheremet Livoreka, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.402/22 të datës 15.11.2022, ka lejuar përmbarimin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përmbarim. Kundër këtij urdhri përmbarimor debitori me datë 05.01.2023 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, pasi që kreditori nuk ka përmbushur në tërësi obligimet sipas kontratës së prokurimit dhe se i njëjti ka qellim të përfitimit të kundërligjshëm, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi, të anulohet urdhri përmbarimor dhe të refuzohet si i pabazuar propozimi i kreditorit për përmbarim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim, e po ashtu i njëjti në kundërshtime ka theksuar se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor, dhe gjykatës i ka propozuar të hedhe poshtë i të pas afatshem.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.102/2023 të datës 30.10.2023, ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit “Construct” shpk, me seli ne Lebane, komuna e Prishtinës të paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.402/22 të datës 15.11.2022, të lejuar nga përmbaruesi privat Sheremet Livoreka si të pas afatshëm, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm, pasi që debitori urdhrin përmbarimor P.nr.402/22 të datës 15.11.2022, të lejuar nga përmbaruesi privat Sheremet Livoreka e ka pranuar me datë 23.12.2022, mirëpo ka refuzuar të e nënshkruaj pranimin, fakt ky që vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa debitori prapësimin e ka paraqitur përmes postës me nr. rekomande R 2744335, me datë 05.01.2023. Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e*

*ardhshme.*” Andaj gjykata duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.402/22 të datës 15.11.2022 e ka pranuar me datë 23.12.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 30.12.2022. Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 05.01.2023, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të postës me nr. rekomande R 2744335, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 6 (gjashtë) ditë vonesë, e mbi këtë bazë gjykata ka vendosur që ta hedh poshtë të njëjtin si të pas afatshëm.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së dhe nenin 183 të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, përcaktohet së: *“Prapësimi duhet ti dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues”*, ndërsa me dispozitën e nenit 73 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, parashihet së: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*. Në këtë kontekst dhe në kuptim të dispozitave të lartcekura, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pas afatshëm prapësimin e debitorit, sepse nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës konstatohet se debitori urdhrin përmbarrimor P.nr.402/22 të datës 15.11.2022 e ka pranuar me datë 23.12.2022, ndërsa prapësimin kundër këtij urdhri e ka paraqitur me datë 05.01.2023, gjë që vërtetohet nga vula e pranimit të postës me nr. rekomand R 2744335, nga del se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor dhe si datë e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 30.12.2022, brenda të cilit afat debitori nuk ka vepruar.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të debitorit nga ana e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe sepse debitori nuk ka mundur t’i provoj pretendimet e tij ankimore për afatshmërinë e prapësimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.45/2024, me datë 05.03.2024.**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**